

PJESA 3

MODELE PROJEKTESH DHE DITARI I VETËVLERËSIMIT



TEMA: PËRCAKTOJMË TEMËN E PROJEKTIT

Fjalë të rralla të vendbanimit

ORA E PARË

QËLLIMI

NXËNËSI aftësohet në:

1. Përzgjedhjen e temës së projektit.
 2. Hartimin e një projekti **për mbledhjen e fjalëve të rralla të vendbanimit**.
- Fjalë kyç:** projekt, temë projekti, fjalë të rralla, fond fjalësh, dialekt, fjalor.

ECURIA E PUNËS NË KLASË

HAPI 1 - Organizimi i nxënësve në punë grupi ose individuale.

Mësuesja/mësuesi iu kërkon nxënësve të shkruajnë një temë për projektin. Ai/ajo u sugjeron nxënësve tri tema të mundshme për t'i orientuar.

Koha 10'

HAPI 2 - DISKUTIM NË KLASË

Koha 20'

Çdo nxënës paraqit temën që ka sugjeruar të jetë temë e projektit që ata do të zhvillojnë.

HAPI 3 - DISKUTIM NË KLASË

Koha 15'

Sipas temës së zgjedhur nxënësit përcaktojnë detyrat që do të zhvillojnë deri në **orën e dytë** të projektit, në Tremujorin e Dytë.

SUGJERIM. Sugjerojmë temën **“Fjalë të rralla të vendbanimit”**. Pse?

Fondi i fjalëve të rralla për çdo qytet apo krahinë në gjuhën shqipe është mjaft i rëndësishëm për kulturën e gjuhës dhe zhvillimin e saj. Gjuha letrare shqipe gjallon fal fjalëve të rralla që gjenden në çdo zonë apo krahinë. Gjithashtu, ajo ndikon dhe në zhvillimin e letërsisë artistike.

DETYRA PËR T’U KRYER DERI NË ORËN E DYTË TË PROJEKTIT. Shkrimi i projektit për temën e **aktuar**. Mund të ndiqni modelin më poshtë ose sipas ndonjë modeli tjetër që mendoni se ju sjell më shumë rezultat.

MODEL PROJEKTI

Projekt kërkimor

Lënda: Gjuha shqipe IX

Klasa: IX

Shkolla: _____

Tema: Të mbledhim fjalë të rralla të vendbanimit tonë.

Rezultatet e të nxënësve

1. Të mbledhë fjalë të rralla dhe të njohë vlerën e tyre;
2. Të njihet me rëndësinë që kanë ato për zhvillimin e gjuhës dhe letërsinë artistike.
3. Të njohë vendin që zënë ato në letërsinë folklorike.

Aftësi kyç: punë në grup, aftësi të paraqitjes së punës dhe të menaxhimit të kohës.

Kohëzgjatja e punës kërkimore: koha nga njëri tremujor në tjetrin.

Koha e shqyrtimit të gjetjeve në klasë: 1 orë tremujori i dytë.

Koha e paraqitjes në klasë: 1 orë tremujori i tretë.

Puna kërkimore: Në grup.

Burime të mundshme për t’u përdorur: Literaturë e shkruar, rrëfime të gjyshërve, folklori i zonës.

Paraqitja në klasë: relacion, ese informuese-përshkruese, PowerPoint, minifjalor, hartë e zonës.

Përgatitur nga _____

Puna kërkimore, mbledhja e të dhënave (intervista, dorëshkrime, veshje, objekte gatimi, këngë, vjersha etj.)

Vlerësimi: Pjesë e të nxënësve me kompetenca, notë.



Tema: Fjalë të rralla të vendbanimit

ORA E DYTË

QËLLIMI

NXËNËSI aftësohet në:

1. Identifikon rëndësinë e fjalëve të rralla dhe ndikimin që ato kanë në jetën dhe kulturën e një vendi.
2. Kontribuon me mbledhjen e tyre, duke i ndarë sipas fushave të veprimtarisë njerëzore.
3. Promovon vlerat gjuhësore dhe kulturore që ato kanë në zhvillimin në jetës, gjuhës dhe letërsisë artistike.

ECURIA E PUNËS NË KLASË

PUNË GRUP

1. Mësuesja/mësuesi ndan nxënësit në grupe pune. Ju kërkon nxënësve të shqyrtojnë materialet e grumbulluara dhe të përzgjedhin ato që i duhet për prezantimin e projektit në orën e tretë, tremujori i tretë.
2. Mësuesja/mësuesi u sugjeron nxënësve disa mënyra për prezantimin përfundimtar të projektit.
3. Nxënësit vendosin vet se si do të prezantojnë punën përfundimtare të projektit, si punë individuale apo si punë në grup.

SUGJERIM

1. Nxënësi paraqet rezultatet e projektit **si punë individuale apo në grup** në një orë mësimore me pjesëmarrjen jo vetëm të klasës së tij, por edhe me pjesëmarrjen e klasave të tjera, me qëllim që të promovojë vlerat e **fjalëve të rralla** të vendbanimit të tyre.
2. Në këtë orë mësimi secili do të prezantojë pjesën e tij të punës, duke paraqitur materiale të ndryshme, si: *këngë, poezi, gojëdhëna, legjenda, përralla, fjalë të urtë*, hartimin e një *fjalori të fjalëve të mbledhura, gatime, veshje tradicionale, emra vendesh (toponimia), emrat dhe mbiemrat e njerëzve (onomastika dhe partonimia)* në klasën ku do të prezantohet projekti.
3. Secili mund të recitojë poezi, të lexojë pjesë letrare nga shkrimtarë të zonës së vet; të paraqesë në **PowerPoint** fjalorin me fjalë të rralla; të njohë pjesëmarrësit me emërtimet e gatimeve tradicionale të zonës; të prezantojë emërtimet e etnografisë dhe toponimisë.





Tema: Fjalë të rralla të vendbanimit

ORA E TRETË

QËLLIMI

NXËNËSI aftësohet në:

1. Prezanton një projekt.
2. Komunikon me njerëzit në veprimtari më të mëdha se klasa.
3. Bashkëpunon me të tjerët.
4. Promovon vlerat gjuhësore të vendbanimit.

AKTIVITETI

Takim me komunitetin shkollor “Fjalë të rralla të vendbanimit”

VENDI: Shkollë dhe kudo që nxënësit mendojnë se është me e vlefshme për ta.

PARAPËRGATITJA

1. Ndezin kompjuterin dhe bëjnë gati programin PowerPoint.
2. Shfaqin materialet e mbledhura të zonës në PowerPoint.
3. Ekspozojnë një ekspozitë të vogël me veshje të ndryshme të zonës.
4. Vendosin dy përfaqësues të presin dhe orientojnë pjesëmarrësit.
5. Një prej nxënësve hap aktivitetin me një fjalë të shkurtër mirëseardhjeje dhe falënderimi për pjesëmarrësit.

PREZANTIMI I REZULTATEVE

Fillon aktiviteti me prezantimin e hartës së vendbanimit, përrallave, legjendave, fjalëve të urta, etnografisë, toponimisë, onomastikës, emërtimet e gatimeve dhe në fund hartimin e fjalorit me fjalë të rralla të vendbanimit të tyre etj.

Pjesëmarrësit shikojnë ekspozitën e veshjeve, kontaktojnë me fjalorin e fjalëve të rralla.

RUAJTJA

Gjithçka filmohet, fotografohet.

VLERËSIMI: Pjesë e të nxënit me kompetenca, notë.





Tema: Libri dhe interneti

Kohëzgjatja: tri orë

Qëllimi: Të mësojmë më shumë mbi librin, internetin dhe mbi përdorimin e tyre në aktualitet. Ky projekt do të realizohet me nismën e mirë për të ndihmuar dhe ndërgjegjësuar të tjerët.

Lënda: Gjuhë shqipe

Pjesëmarrësit: Klasa IX

Përshkrimi: Në këtë projekt do të synohet të dalë në pah marrëdhënia e nxënësit me librin dhe celularin. Do të tregohet dhe diskutohet për të mirat, problemet, kuriozitetet dhe këshillat për përdorimin e tyre dhe se si na ndihmojnë ata në jetën e përditshme.

Veprimtaria sipas linjës kohore: Projekti do të zhvillohet në tri orë, por do të përgatitet për një periudhë kohore tremujore. Fillimisht nxënësit do të njihen me temën e projektit. Bëhet ndarja e grupeve dhe caktohen liderët për çdo grup dhe lideri kryesor. Pas ndarjes së grupeve caktohen punët që gjithsecili do të bëjë brenda grupit, përmes një bashkëpunimi të frytshëm mes tyre. Më pas, anëtarët e çdo grupi do të hulumtojnë për të grumbulluar materialet e nevojshme. Në fazën e dytë do të prezantohet puna e çdo grupi në varësi të detyrave të ngarkuara, që do të përmbledhen më pas, në fazën e tretë, pas përpunimit, në një projekt të vetëm që ka ardhur si rezultat i punës në grup apo individuale dhe do të prezantohet nga lideri kryesor. Gjatë prezantimit të produktit do të argumentojnë atë që kanë sjellë në produkt duke interpretuar çdo qasje të tij. Në përfundim do të bëhet vlerësimi për çdo pjesëtar grupi, si dhe për organizimin e punës në grupe.

Burimet: Wikipedia, Google Images, Clip Art, Tv Skampa, World Vision, Top Channel dhe informacionet që gjithsecili prej jush ka pasur mbi këtë temë.

Përfitimet: Njohuri të shumta mbi librin dhe teknologjinë. Rëndësia dhe ndihmesa e tyre në jetën e përditshme dhe avantazhet dhe disavantazhet e përdorimit të librit dhe celularit. Ndërgjegjësimi për përdorimin e tyre.

NXËNËSI:

- a. **Diskuton** për rëndësinë e librit dhe të internetit;
- b. **Mëson** më shumë rreth librit dhe internetit;
- c. **Analizon** avantazhet dhe disavantazhet;
- d. **Krijon** raporte midis internetit dhe librit;
- e. **Merr** pjesë aktive në punën në grup dhe ndarjen e detyrave në të;
- f. **Përzgjedh** materialet e duhura për realizimin e projektit;
- g. **Bën** sistemin e materialeve të përgatitura.

ORA E PARË

1. Nxënësit janë njohur më parë me temën e projektit.
2. Kalohet në diskutim.
3. Nxënësit flasin rreth librit dhe internetit, si pjesë e celularit.
4. Libri është miku ynë, është tërësia unitare, e ilustruar ose jo, e botuar nën një titull në çfarëdo forme.
5. Zakonisht libri është një vepër letrare, mësimore, shkencore etj., me fletë të shtypura së bashku në një vëllim dhe i cili del në shitje.

Libri përmban art dhe arti na ushqen shpirtin. Liria dhe gjendja e shkrimtarit transmetohet në një mënyrë fare të natyrshme. Ju ndiheni të përfshirë në një situatë sa intelektuale dhe familjare. Ky mik, libri, ju jep përgjigje pa u bërë ju pyetje, ju jep ndihmë pa ia kërkuar ti, pra libri është i shkruar

dhe i projektuar për njerëzit. Vetë natyra njerëzore ka nevojë për një botë të dytë, që ta përfshijë dhe ta largojë ndonjëherë nga ajo realja, si të jetë një kurë apo një mekanizëm i pavullnetshëm mbrojtës.

Ndarja e grupeve (nxënësit e bëjnë vetë ndarjen e grupeve dhe të detyrave për secilin grup)

1. Arsyet e të lexuarit, rëndësia e librit si burim i dijes. Shprehje rreth librit “Probleme”.
2. Fakte interesante rreth librit, librat tanë të parapëlqyer, ese për librin, vlerat e librit.
3. Libri dhe teknologjia sot. Fakte interesante rreth internetit. Bullizmi.
4. Rrjetet sociale si po i përfshijnë fëmijët. Ndikimi negativ i internetit. Rreziku i internetit. Lojërat online-rreziqet. Lojërat tona të parapëlqyera. Largimi nga aktiviteti fizik.
5. Libri apo teksti digjital. Celulari-sëmundje e brezit të sotëm.

Vlerësim: Vlerësohen nxënësit për ndarjen e detyrave në grup dhe marrjen pjesë në diskutim.

ORA E DYTË

Në këtë fazë bëhet:

- a. Përpunimi i materialeve nga anëtarët e grupeve, njohja me punën e deritanishme;
- b. Krijimi i posterave;
- c. Krijimi i punimit në PowerPoint;
- d. Krijimi i videos me punët individuale;
- e. Kërkimi në internet;
- f. Shfrytëzimi i internetit në jetën e përditshme.


Lideri i grupit është i vëmendshëm për punën që kryen secili nga anëtarët e grupit dhe bën vlerësimin e tyre. Diskuton për rëndësinë e librit, lidhjen midis tij dhe internetit. Secili nga liderët ndalet në problemet që janë hasur gjatë hulumtimit të përgatitjes së produktit. Drejton punën në grup. Prezanton produktet e projektit fjalët kyçe: internet, web, facebook, rrjete sociale, libër, subjekt, mesazh.

ORA E TRETË

Gjatë prezantimit të punës përfundimtare me video-projektor, tabela dhe albume, nxënësve u sugjerohet të ndahen në dy grupe duke marrë njëri grup rolin e librit dhe grupi tjetër rolin e celularit. Secili grup do të mbrojë objektin e caktuar me argument sa më bindëse për zgjedhjen që ka bërë. Në këtë fazë do të vlerësohen nxënësit. Mësuesja duhet të jetë transparente në vlerësim, po kështu dhe pjesëtarët e grupit me njëri-tjetrin.

Përfundimi: Libri, interneti (celulari) apo duhet një lloj bashkëpunimi mes tyre?

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrje në punën në grup, përzgjedhjen e materialeve të duhura për produktin final, mënyrën e prezantimit, si dhe kryerjen e detyrave të ngarkuara.





Letërsia dhe folklori. Ndikimi i shkrimtarëve nga folklori

SYNIMI

NXËNËSI:

- Orientohet** drejt një gjuhe shqipe dhe letërsie të mirë e të përshtatshme për moshën e tij;
- Mëson** se si të përdorë saktë gjuhën shqipe, të analizojë një tekst letrar, në mënyrë që ta kuptojë, ta shijojë dhe t'i vlejë për të ardhmen;
- Nxitet** pozitivisht që të lexojë, dëgjojë, flasë mbi tekste të ndryshme, si dhe të shkruajë tekste kryesisht letrare për të shprehur botën e tij të brendshme të mendimeve dhe të ndjenjave, por edhe si një komunikim i brendshëm me botën që e rrethon;
- Krijon** një njohje më të plotë lidhur me kompetencën teorike të tij rreth leksikologjisë, drejtshkrimit, gramatikës së gjuhës shqipe dhe analizës së tekstit letrar, veçmas atij tregimtar;
- Nxitet** interesi për të lexuar, hulumtuar dhe bërë hapa të sigurta drejt punëve studimore;
- Bashkëpunon** me shoqet/shokët.

Në fund të projektit nxënësi:

- Lexon** tekste letrare për të kuptuar përmbajtjen e tyre, për të gjykuar, interpretuar, krahasuar dhe ndërtuar paralele midis letërsisë gojore dhe asaj të kultivuar;
- Përdor** drejt gjuhën shqipe;
- Përzgjedh** fjalë të pasurisë së gjuhës amtare e të huazuar leksikore;
- Analizon** veçoritë e tekstit tregimtar sipas elementeve të strukturës së rrëfimit të mësuar në shkollë;
- Reflekton** mbi problematikat e ngritura;
- Jep** rrugëzgjdhje të mundshme;
- Analizon** gjuhën e tekstit tregimtar;
- Analizon** teknikat e rrëfimit;
- Përshkruan dhe analizon** sistemin e personazheve;
- Provon** të krijojë tregim fantastik;
- Gjykon** mbi vlerat e librit;
- Bashkëpunon** në grup për të realizuar detyrat e ngarkuara.

Në fund të projektit nxënësi shkathtësohet në:

- Interpretimin, analizimin dhe vlerësimin** e elementeve të përmbajtjes, të strukturës dhe të formës së përrallës;
- Analizimin dhe vlerësimin** e rrëfenjave të Kutelit dhe veçon ndikimin e tij nga folklori (fabulën, skemën e përgjithshme, elementin fantastik, personazhet fantazma, regjistrin, frazeologjizmat, rrëfimtarin, vetën e rrëfimit etj);
- Analizimin dhe vlerësimin e tregimit të Koliqit**, duke shquar ndikimin e tij nga folklori (përrallat, gojëdhënat, skemat e përgjithshme, elementin fantastik, gjuhën e pasur);
- kërkimin e ndërtimin e krahasimeve** për të gjetur pika ngjashmërie apo ndikimi, por dhe për të dalluar fuqinë e origjinalitetit të Kutelit e Koliqit.

Metodologjia: Lexim i veprave të këshilluara, skedim i materialit, diskutime, harta e strukturës së rrëfimit, përpunim kompjuterik, punë me shkrim-ese, tregim, plotësim i skedave të gatshme për personazhet, internet.

Partnerët në projekt :

Nxënësit e klasës IX

Mësuesi i lëndës IX

Burimet kryesore të informacionit : Proza Popullore Shqiptare (Instituti i Folklorit); tregime të moçme shqiptare-Mitrush Kuteli; Hija e maleve-Ernest Koliqi.

Rezultatet e pritshme :

- » **Lexon** një tekst tregimtar të plotë.
- » **Analizon** një tekst tregimtar popullor dhe të letërsisë së shkruar.
- » **Shkruan** saktë shqipen standarde.
- » **Përzgjedh** fjalë të leksikut tonë nga fragmentet.
- » **Mbështet** me detaje nga tekstet çdo analizë që bën.
- » **Shkruan** tekste të ndryshme letrare bazuar në këto vepra.
- » **Analizon** në mënyrë të imtësishme një tekst.
- » **Kultivon** ndjenjën e punës kërkimore.
- » **Bashkëpunon** me shokët për të arritur rezultate.

NDARJA E GRUPEVE

Klasa ndahet në tri grupe. Secili grup do të merret me leximin , studimin e çështjet e mëposhtme:

Grupi I

Proza Popullore Shqiptare: ndalet në studimin kryesisht të përrallës fantastike popullore , në veçoritë, llojet, ndërtimin, sistemin e personazheve etj.

Grupi II

“Tregime të moçme shqiptare”, ndalet kryesisht tek tregimi “Rinë Katerinëza”

Grupi III

“Hija e maleve”- E. Koliqi, ndalet kryesisht tek tregimi “Nusja e mrekullueshme.”

Përshkrimi përmbledhës i veprimtarisë kryesore :

Secili grup do të bëjë një paraqitje të detajuar sipas kërkesave.

Përpunimi i relacioneve përkatëse.

Kohëzgjatja: 3 orë mësimore (1 orë – 45’)

Rezultati konkret:

Realizimi i referateve

Shkrimi i teksteve letrare e jo letrare

Tematika e secilës orë mësimi dhe përshkrimi i saj

Ora e parë: Diskutimi për temën, përcaktimi i temës, qëllimit dhe pritshmërive të këtij projekti.

Diskutohet për rëndësinë e leximit të librave, për lidhjet e forta që ka letërsia e shkruar me letërsinë gojore popullore.

Nxënësit sqarohen rreth punës kërkimore, për kohën që kanë në dispozicion, për etapat nëpër të cilat do të kalojë ky projekt .

Bëhen sqarime për skedimin e materialeve.

Krijimi I grupeve, ndarja e specifikuar e punës, caktimi I liderit, ndarja e punës brenda grupit.

Ora e dytë: Diskutim rreth ecurisë së punës. Bisedohet me liderët e grupeve për fazën në të cilën janë punët e grupit në tërësi dhe të nxënësve të veçantë.

Shpjegime e sqarime për skedimin e materialit dhe shënimet e cdo kryetari grupit.

Sqarohen nxënësit si të ndërtojnë produktin përfundimtar, si të hartojnë relacionet përmblylëse të punës kërkimore, si ta paraqesin atë estetikisht dhe si ta prezantojnë gojarisht.

Ora e tretë: Prezantimi i produktit përfundimtar

- Relacion për punën e bërë nga grupi. Në këtë fazë përfundimtare, secili grup paraqet rezultatet e punës së tij (relacionin dhe seksionin përkatës të çështjeve).
- Hartimi i një fletëpalosjeje me informacion të përmbledhur.
- Lexim dhe diskutim i punës.
- Paraqitja mund të bëhet me kompjuter ose me video-projektor, prezantim me PowerPoint.

Zhvillimi i aktivitetit :

5' - Prezantimi i synimeve, objektivave të projektit dhe çështjeve që lidhen me temën.

30' - Paraqitja e punës së grupeve.

10' - Vlerësimi i grupit me fjalë dhe notë.

Mënyra e vlerësimit të nxënësve :

Nxënësit paraqesin referatin e punës së tyre.

Nxënësit shkruajnë saktë dhe qartë punët e tyre.

Mbështesin me detaje nga teksti.

Kryetari i grupit sqaron punën e secilit në grup dhe etikën e secilit në punë. Vlerësohet serioziteti në kërkim, idetë origjinale, hartimi i tekstit, saktësia e analizës, krahasimi i punës së grupeve, origjinaliteti dhe krijueshmëria, mënyra e paraqitjes gjuhësore të materialit.

Vlerësimi në grup (20%) dhe individual (80%).

Buxheti:

Nxënësit do të blejnë librin me buxhet individual, do t'u nevojiten fletë format për të skeduar materialin, shumë modeste parash për të printuar materialin, kartona për të krijuar postera të paraqitjes së materialit, punimi në kompjuter.

PUNË TË MBARË!



DITARI I VETËVLERËSIMIT

I VLEFSHËM PËR ÇDO TREMUJOR

Ky ditar i përket: _____

Emër, mbiemër: _____

Shkolla: _____

Klasa: _____

Miku ynë i mirë, _____

Ka kaluar disa muaj që ti e mban në duar këtë libër. Ke mësuar e je bërë më i ditur, e ke zgjeruar hapësirën e mendjes sate dhe je gati të hedhësh hapa të rinj e më të mëdhenj përpara. Lënda që ke kaluar nëpër duar ka pasur të veçantat e saj. Diku ti je ndier më mirë, më i fortë, diku, mbase e ke ndier veten ca si ngushtë. Ndaj është mirë të dish se çfarë ke bërë, ku ke arritur, çfarë s'ke bërë dhe çfarë duhet të bësh dhe si ta bësh. Për këtë të shërben "Ditari i vetëvlerësimit". Ti duhet të ndërgjegjësohesh për veten tënde, të jesh i sigurt për ato që shkruan, duke shënuar arritjet dhe mosarritjet e tua, që vetëvlerësimi të jetë sa më i vërtetë e të të shërbejë ty për të vazhduar më tej. Që të mund ta plotësosh këtë ditar, ti duhet të shfletosh librin për të kujtuar temat e mësimeve që ke marrë dhe të reflektosh rreth njohurive dhe veprimtarive që ke kryer deri tani.

Po jua shpjegojmë si mund ta plotësoni ditarin tuaj të vetëvlerësimit:

Çfarë kam arritur të mësoj deri tani?

1. Me anë të mësimeve që kam marrë deri tani, mendoj se kam zhvilluar më shumë aftësinë e _____ (të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit, të lexuarit), nëpërmjet _____ dhe më pak aftësinë _____, sepse _____.

2. Me anë të veprimtarive të kryera, si: _____ sidomos në mësimin mbi _____ mendoj se jam shkathtësuar në _____ (të kuptuarit, të interpretuarit, të menduarit në mënyrë kritike dhe krijuese), kur duhet të bëj edhe më tepër në: _____

3. Gjatë punës për marrjen e dijeve të reja mbi _____ gjykoj si një vlerë të rëndësishme që duhet ta ruaj e ta forcoj _____ (p.sh., respektimin e rregullave të etikës gjatë të folurit, seriozitetin, guximin për të shprehur atë që mendoj dhe ndiej) dhe mund të bëj më shumë për ta bërë vlerë timen _____

4. Aftësitë e mia në përdorimin e drejtë të gjuhës në të folur e në të shkruar janë përmirësuar në drejtim të _____

Por më mbetet të bëj edhe me shumë për _____

5. Shënoni veprimtaritë që keni zhvilluar e keni marrë pjesë (diskutime, debate, shtrim dhe zgjidhje problemesh, argumentim çështjesh, paraqitje individuale, komente, fjalë para shokëve, të dëgjuar tekstesh).

6. Pasi ta keni shfletuar lëndën që keni zhvilluar dhe veprimtaritë që keni kryer për të, plotësoni si më poshtë:

a. Unë di mirë konceptet kryesore të lëndës në drejtim të (komunikoj, kuptoj, shkruaj, lexoj, analizoj, interpretoj, dalloj, kuptoj ndryshimet, krahasoj, përdor mjetet digjitale)

b. Unë nuk di mirë (të paktën dy çështje) _____

c. Çfarë duhet të përmirësoj _____

d. Në ç'mënyrë mendoj t'i përmirësoj _____

Në këtë rubrikë ju mund të përmblihdhni anët tuaja më të forta, ato ku ju mendoni se keni arritur një nivel të lartë përvetësimi, si p.sh.:

1. Unë di mirë:

- të shkruaj qartë, pa gabime drejtshkrimore;
- të bëj lexim shprehës;
- të dëgjoj me vëmendje të përqendruar dhe të mbaj mend;

2. Unë nuk di mirë:

- të zbatoj normën standard në të shkruar;
- të përqendrohem në të dëgjuar;
- të bëj dallimet e mënyrave të ndryshme të formimit të fjalëve, të fjalët ku ky formim është me përzierje të dy e më shumë mënyrave;
- të gjej figurat letrare;
- bëj dallimin e esesë bindëse me atë argumentuese;
- Dhe në fund: përshkruaj veten tënde në këtë nivel të arritjeve të tua.